

Java Evropiane e SME-ve 2011

3 deri 9 Tetor 2011

Java Evropiane e SME-ve është një fushatë pan Evropiane e koordinuar nga Komisioni European, Drejtoria e Përgjithshme e Ndërmarrjeve dhe Industrisë, që udhëhiqet nga principet e Small Business Act. Shqipëria i është bashkuar kësaj nisme që gjatë vitit 2010, me qëllim për të stimuluar veprimtarinë në fushën e SME-ve në nivel kombëtar apo rajonal dhe për të mundësuar sjelljen e eksperiencave dhe praktikave më të mira, me qëllim për të promovuar arritjet e tyre.

Zhvillimi i sektorit privat, në vecanti i SME-ve, është një ndër prioritetet e qeverisë. Aktualisht në vendin tonë operojnë rreth 106 mijë biznese private, që kontribuojnë në mbi 80% të GDP dhe mbulojnë rreth 82 % të numrit të përgjithshëm të punonjësve.. SME-të përfaqësojnë 99.9 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive në Shqipëri.

Java Evropiane e SME-ve do të shërbejë si një vlerë e shtuar si për qeverinë dhe organizatat e biznesit, për ta kthyer ato në programe për veprim, në mbështetje të rritjes së konkurrencës së SME-ve.

Sa më sipër njoftojë të gjitha organizatat publike dhe private që të bëhen pjesë aktive e kësaj jave Evropiane të SME-ve, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme promovionale për sipërmarrjen, për prezantimin e shërbimeve që ofrojnë për bizneset dhe për të mësuarit për sipërmarrjen.

Për më tepër aplikoni e regjistroni aktivitetin tuaj në: <http://ec.europa.eu/sme-week>

Gjithashtu njoftojmë të gjithë të rinjtë e të interesuar të tjerë, që të bëhen pjesë aktive me pjesëmarrje në këto aktivitete, për të mësuar sa më mirë për të qënë të sukseshëm në sipërmarrjet e tyre në jetë.

